

FATOS KONGOLI
VEPRA

ILUZIONE NË SIRTAR
AUTOBIOGRAFI

12

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

VEPRA

1. Ne të tre - *roman*
2. I humburi - *roman*
3. Kufoma - *roman*
4. Dragoi i fildishtë - *roman*
5. Ëndrra e Damokleut - *roman*
6. Lëkura e qenit - *roman*
7. Te porta e Shën Pjetrit - *roman*
8. Jetë në një kuti shkrepësesh - *roman*
9. Në pritje të Nostradamusit - *tregime*
10. Karuseli - *roman*
11. Bolero në vilën e pleqve - *roman*
12. Iluzione në sirtar - *autobiografi*
13. Si-do-re-la - *roman*
14. Njeriu me fat - *roman*
15. Gjemia e mbytur - *roman*
16. Gënjeshtarë të vegjël - *roman*
17. Kapitulli i Amerikës - *autobiografi*
18. Stinë pandemie - *roman*
19. Misteri i mjellmës - *roman*
20. Ballo me maska ose shakaja e fundit - *roman*

FATOS KONGOLI
VEPRA

ILUZIONE
NË SIRTAR

autobiografi

12

BOTIMET TOENA

Botim i veçantë në kuadër të Veprës.

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960658

© AUTORI dhe BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

1.

Ende pa nisur ta shkruaja këtë libër, në kokë më vërtitej titulli “Në kërkim të kohës së humbur”. Disi për paradoks! Them kështu sepse Prustin nuk e kam lexuar. Ndër vite jam orvatur disa herë ta lexoj, pa sukses. Niveli im i gjuhës frënge asnjëherë nuk mbërriti deri atje, sa të mund të lexoja dhe shijoja Prustin. Kam lexuar dhe shijuar në këtë gjuhë autorë të tjerë, francezë dhe jo francezë, të mëdhenj, më pak të mëdhenj apo të zakonshëm, por Prusti ka qenë për mua një “kockë e fortë”, aq sa më në fund hoqa dorë. Kam hequr dorë, po për këtë arsye, edhe nga leximi i disa autorëve të tjerë, për shembull Xhojsi, e kam fjalën gjithmonë në frëngjisht. Më vonë mbaj mend të jetë botuar diçka e përkthyer në shqip nga Prusti, edhe nga Xhojsi, por tashmë dëshira për t`i lexuar më kishte ikur, ndoshta sepse tepër vonë për mua për t`i njohur. Sidoqoftë, titulli “Nën kërkim të kohës së humbur”, i shkëptutur nga konteksti i universit prustian, u rrënjos pashlyeshëm në vetëdijën time dhe, pas disa dekadash errësire, mbërriti një çast kur m`u duk se në pjesën e mbetur të jetës s`mund të bëja gjë tjetër veç të rendja “në kërkim të kohës së humbur”. Ky është dhe motivi i këtij libri, kërkimi i kohës sime të humbur, në jetë dhe në letërsi.

Ngurrova gjatë, disa muaj, para se të ulesha ta shkruaja. Ideja më ngacmoi me të mbaruar romanin tim më të fundit “Bolero në vilën e pleqve”. Në intervista me rastin e botimit të tij kam pohuar se ai më mundi, se e kam shkruar në kushte stresi, nga frika e një dështimi. Unë nuk kam shkruar me lehtësi ndonjë libër, përveç romanit “I humburi”. Këtë e përfundova në një kohë rekord për mua, brenda gjashtë muajsh, qershor-dhjetor 1991. Të tjerët, e kam fjalën për libra të pas viteve `90, i kam shkruar në kushte të ndryshme, por me një ndjesi të përbashkët për të gjithë: nën trysninë e atij që e quajnë “terrori i faqes së bardhë” (la terreur de la page blanche).

Nuk e di kujt i përket kjo thënie, ndoshta një autori francez, përderisa shprehja më është ngulitur në frëngjisht. Ajo jep saktë gjendjen time emotive kur ulem të shkruaj, midis dëshirës dhe frikës, sikur jam futur në një kopsht të ndaluar. Kjo ndjesi më është ngulitur gjatë viteve të gjimnazit kur nuk e dija ç’ishte “terrori i faqes së bardhë”, por lexoja ç’të më binte në dorë, me parapëlqim poezinë. Ëndrra ime e fshehur, si e të gjithë fillestarëve, ka qenë të bëhesha poet. Shkruaja vjersha, ato që shkruaja nuk ia tregoja njeriu, ishin “sekreti” im. Nëse do të merrja guximin t’ia tregoja dikujt e ky dikush nuk do t’i pëlqente, për mua kjo mbase do të barazohej me fundin e botës. Tani mund të bëj një interpretim të këtij naiviteti, përzier me frikë: letërsia ka qenë për mua qysh në fillim, kur përfytyrimet e mia për të ishin elementare, një tempull i shenjtë. Autorët që botonin atëherë ishin për mua njerëzit më të zgjedhur, i adhuroja barazisht, ata i përkisnin një tempulli të shenjtë. Nga ky, po them, hyjnizim

i poetëve dhe shkrimtarëve të kohës zura të çliroheshja në vitin e tretë, sidomos të katërt të gjimnazit, kur pak a shumë mund ta bëja dallimin midis poezisë dhe vargëzimit. Në prozë kjo ndodhi më vonë, shumë më vonë se çasti kur unë vetë fillova të shkruaja prozë.

Të shkruarit ka qenë e mbetet për mua puna më e vështirë, e kam cilësuar “punë skllavërore”. Lidhur me këtë ka ndodhur të kem keqkuptime dhe debate me kolegë. Pohimi im rreth të shkruarit si një “punë skllavërore” ka ngjallur më së paku habi. Një kolege më tha një herë se të shkruarit ishte për të kënaqësi, gati një lodër zbavitëse dhe nuk do të shkruante asgjë po qe se kjo do t`i shkaktonte stres. Mbase është kështu. Secili ka marrëdhënien e vet me letërsinë.

E hapa këtë parantezë nisur nga romani im i fundit “Bolero në vilën e pleqve”. Ky është një libër “kufitar” për mua, si romani “I humburi”. Duke qenë libri im i parë që shkruajta në rënie e sipër të regjimit komunist, “I humburi” shënon njëherazi ndarjen e dy epokave, nëse mund t`i quaj kështu, në trajektoren time letrare. Atë të epokës diktatoriale, nën shenjën e realizmit socialist, dhe të epokës postkomuniste kur, me shembjen e regjimit, një ditë të bukur u ndjeva i çliruar nga demoni i frikës, rrjedhimisht nga autocensura, fantazma e përhershme e netëve të mia. Kjo është një ndarje e vendosur konvencionalisht, në rrethana të caktuara, në një vit të caktuar. Brenda meje ndarja ishte kryer prej vitesh, në heshtje dhe sapo u krijuan kushtet, këtë akumulim ndër dekada e nxora me një frymë në trajtën e romanit “I humburi”. Në çdo pikëpamje, edhe në kohë fizike të botimit të tij, “I humburi” shënon një fazë të re në trajektoren time.

Këtë domethënie ka për mua tani “Bolero në vilën e pleqve”, në kushte krejt të ndryshme. “I humburi” u shkrua në një moment përmbysjeje, ndryshimi epokash. Tani s`ka përmbysje, ndryshim epokash. Po të mos përmend rotacionin mediokër të pushteteve, kur në fuqi vjen herë e djathta herë e majta, çka nuk ka lidhje me letërsinë, në rastin më të mirë mbetet vetëm një sfond. Është folur shumë për atë që në jetën tonë të përditshme ka hyrë me termin “tranzicion”, duke cilësuar kështu epokën që nisi me shembjen e regjimit diktatorial. Sipas disave, tranzicioni vazhdon edhe sot, sipas disa të tjerëve, me futjen e Shqipërisë në NATO dhe shpresat për t`u bërë anëtarë të familjes europiane, - term i huazuar nga politika, - tranzicionin e kemi lënë prapa dhe mund të quhemi një vend normal.

Dakord, do të më pëlqente ta quaja edhe unë veten qytetar i një vendi normal. Do të më pëlqente gjithashtu të zgjatesha në këtë pikë, është një temë interesante sepse, ç`do të thotë të jesh qytetar normal i një vendi normal?

Mua, për shembull, më kanë quajtur “shkrimtar të tranzicionit” ndoshta sepse librat e mi më të rëndësishëm i kam shkruar pas përmbysjes së diktaturës kur, ballafaquar me konceptin e vendit “normal”, shoqërisë “normale”, jemi karakterizuar nga parametra anormalë, rrjedhimisht do të më duhej të pranoja se në librat e mi, për afër dy dekada, jam marrë me anormalitetin, me ngjarje anormale, personazhe dhe qenie anormale. Pa dashur të komentoj, po i drejtohem për ndihmë një vërejtjeje që më bëri një ditë një miku im poet. Ai më tha qortueshëm: “Fatos, më vjen keq, por ti je një njeri pa pikëpamje”. Ndryshe nga ç`priste

ai, nuk iu kundërvura, përkundrazi, i dhashë të drejtë, i thashë se isha siç thoshte ai, një njeri pa pikëpamje. “Si personazhet e librave të mi, shtova, ata nuk shquhen të kenë pikëpamje”.

Kjo bisedë më mbeti në mendje për një kohë të gjatë. Vërejtja dhe përgjigjja ime ishin dhe janë dy anët e një të vërtete. Pasi mbarova romanin “Bolero në vilën e pleqve”, i mbetur bosh, siç më ndodh sa herë që mbaroj një libër, mendova se unë vetë e kisha jetuar jetën time si një roman. Nga përvoja e dija, do të më duhej të bëja një pushim derisa edhe “Bolero...”, siç kishte ndodhur me të gjithë pararendësit, të dilte jashtë meje dhe, po ashtu siç kishte ndodhur gjithmonë, të filloja të mbushesha me diçka tjetër. Në vitet e gjimnazit kam lexuar në revistën “Nëntori” një intervistë të Heminguejt, ndër të rrallat që më ka mbetur në mendje nga ajo kohë, për aq sa më ka mbetur pas pesëdhjetë vjetësh, çka do të thotë se, sa më poshtë, mund të mos jetë një riprodhim i saktë i versionit të përkthimit në shqip të intervistës. Ndër të tjera, siç më është ngulitur mua, Heminguej thoshte aty se pasi mbaronte së shkruari një libër priste që “pusi” i tij i mbetur bosh të rimbushej, derisa mbërrinte çasti kur ai fillonte ta shteronte përsëri. Po aty, Heminguej vërente se kur “rimbushja” vononte, për t’i dhënë zemër vetes, ai rilexonte ndonjë nga librat e vet të botuar, që të bindej se do të mund të shkruante edhe të tjerë.

Heminguej ka qenë një nga shkrimtarët më të adhuruar të brezit tim, regjimi nuk e përfshinte në listën e zezë të autorëve të ndaluar, ndoshta nisur nga fakti se ai kishte marrë pjesë në Luftën e Spanjës, në anën e brigadave internacionale. Romane dhe tregime të tij, përfshirë novelën

“Plaku dhe deti”, ndikuan dukshëm në mënyrën e të shkruarit të disa prozatorëve të rinj të kohës. Atëherë unë vetëm vargëzoja. Do të duhej të kalonin shumë vite që t`i bija në të se ku e kishte pasur fjalën Heminguej. Dhe të përjetoja realisht atë që nuk është gjë tjetër veçse ankth i të mbeturit bosh, frikë e shterimit.

Për afër njëzet vjet kam qenë me fat, “pusi” është rimbushur shpejt. Këtë prita edhe pasi u botua “Bolero...”. Ai u vlerësua, mora urime, botuesi im, zoti Toçi, në një e-mail që më dërgoi pas leximit të dorëshkrimit, më thoshte: “Nuk e di se çfarë do të shkruash pas këtij libri!”. Ç`është e vërteta, e kisha një ide, të mjegullt. Zakonisht, një ide e mjegullt ka qenë për mua gjithmonë shenjë se herët a vonë do të ulesha të shkruaja. Kësaj radhe, ndryshe nga më parë, po ngurroja. Në njëzet vitet e fundit, libër pas libri, kisha vendosur me lexuesin një kontakt të qëndrueshëm, një marrëdhënie mirëbesimi. Por një shqisë më frenoi. Rreziku më i madh për një autor, që nuk e ka letërsinë mjet jetese, për më tepër shkrimtar në një vend të vogël, me një lexues jo fort të durueshëm për natyrë, është shpërdorimi i besimit të tij, euforia. Shtoi kësaj edhe një të vërtetë tjetër. Në letërsi dhe arte është e pashmangshme dukuria e konsumimit. Ndodh shpesh pasi ke arritur suksesin ta shohësh veten në pozitë jo të favorshme. Puna arrin deri atje sa përgojohesh nga persona që as të kanë lexuar, as e marrin mundimin të të lexojnë. Te ne, fatkeqësisht, kjo dukuri është e përhapur.

Pra, megjithëse e kisha një ide të mjegullt, pas “Boleros”-s nuk po guxoja t`i kthehesha tryezës së punës, derisa m`u duk sikur kuptova

diçka. Ngurrimi im nuk lidhej me faktin e “pusit” të zbrazur, ishte më i ndërlikuar. Vjen një ditë kur një autor nuk është keq t`i kujtojë vetes atë proverbin, - anglez kam dëgjuar të thonë, - sipas të cilit “ose hesht, ose thuaj diçka më të mirë se heshtja”. Mirëpo kjo alternativë në rastin e një shkrimtari është e vështirë për t`u ndjekur, nëmos e pamundur. Për një shkrimtar, të mosshkruarit, mesa duket, është baraz me vdekjen.

Vendimi për të hequr dorë nga një ide e mjegullt që kisha për një roman të ri, u ndikua nga gjithçka thashë më sipër. Dhe një nevojë për të vendosur rregull brenda vetes. Si personazhet e mi. Këta, përgjithësisht, e kanë të domosdoshme të vendosin rregull brenda vetes. Dhe rrëfehen. Kjo ka bërë që prej kohësh lexuesit të më shtrojnë pyetjen nëse romanet e mi janë autobiografikë. Zakonisht kam zgjedhur të përgjigjem në mënyrë evazive: janë dhe nuk janë romane autobiografikë. Më tej, pas çdo libri ata më kanë drejtuar të njëjtën pyetje dhe unë kam dhënë të njëjtën përgjigje, pa e vrarë mendjen përse kjo ka qenë pyetja më këmbëngulëse ndaj meje dhe përse unë kam këmbëngulur të përgjigjem gjithmonë në të njëjtën mënyrë.

Unë nuk e di mirë as vetë se në ç`masë jeta ime përzihet me jetën e personazheve të mi. Në këtë kuptim “vendosja e rregullit” brenda vetes më duket punë e vështirë. Hapi i parë i domosdoshëm për këtë do të ishte t`i drejtohesha që në krye një personazhi që, për mirë a për keq, ka ndikuar më shumë se kushdo tjetër tek unë. Ky ka qenë im atë, Baki Kongoli (1913-1980). Disa dekada më parë, kur mbarova maturën, ai më kërkoi të studioja për matematikë, dhe unë iu binda, dhe u ndieva

i shpërngulur. Për shumë kohë mbeta në erë, midis matematikës dhe letërsisë, pa shkuar as te njëra as te tjetra, me një dyzim të vetvetes, midis njeriut racional që orvatej të kultivonte tek unë matematika, të rregullt, metodik e të logjikshëm, i aftë të kuptojë si duhet thelbin e gjërave, t'í thotë të bardhës të bardhë dhe të zezës të zezë, dhe njeriut irracional, plot iluzione, i pasigurt në vetvete, me vese. Mbi të gjitha rob i letërsisë, i pazoti të marrë vendime dhe të ngurrojë t'í thotë të zezës të zezë e të bardhës të bardhë edhe kur e sheh qartë se e zeza është e zezë dhe e bardha e bardhë, dhe nuk reagon thjesht sepse nuk ka nerva. Por të kthehem tek im atë.

Me studime të kryera për violinë në Itali, në konservatorin e Paviors, ish-pedagog në Normalen e Elbasanit, ish-komunist, më pas i dënuar, pjesëmarrës në Luftën Nacional-Çlirimtare, kompozitor, autor i dhjetëra këngëve dhe i dy operetave, sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë për shumë vite, deputet i Kuvendit Popullor në dy legjislatura, me kredi në sferat më të larta të nomenklatures së regjimit, së cilës i shërbeu besnikërisht deri në fund, kur e flakën si limon i shtrydhur, njeri gazmor e me humor gjithmonë pozitiv, im atë ka qenë personi më kontradiktor që kam njohur. Një fakt domethënës: ai ishte një lexues i fortë. Nuk e kam fjalën për literaturën muzikore. Në shtëpi gjeja gjithmonë libra në frëngjisht, kryesisht romane, të cilët, si funksionar i Lidhjes, ai duhej t'í merrte ose në bibliotekën e saj, të pasur për kohën, ose në atë të shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, ku punova për mëse pesëmbëdhjetë vjet. Fakti që im atë

ndoshta lexonte më shumë se pjesa dërmuese e shkrimtarëve të kohës, nuk mund të kalonte pa lënë gjurmë tek unë, siç nuk mund të kalonin pa lënë gjurmë njohjet e tij me shkrimtarë dhe artistë, para se të caktohej sekretar i Lidhjes për muzikën dhe më pas. Më vonë unë vetë do të punoja në Lidhje për disa vjet, në periudha të ndryshme, në gazetën “Drita”. Të gjitha këto më mundësuan të njihja nga afër botën letrare-artistike të kohës. Pa qenë protagonist, kam qenë dëshmitar i disa çasteve kulmore, dramatike të Lidhjes, i ngjarjeve që e tronditën atë në themele. Derisa nga dinosaur, siç ishte në epokën e diktaturës, u shndërrua brenda natës në hardhucë, një hardhucë që mbijetoi për inerci edhe disa vjet.

Nuk kam ndërmend, as jam në gjendje, të ndërtoj një histori sado sipërfaqësore të Lidhjes. Ajo thjesht dhe pashmangshëm do të jetë e pranishme në këto shënime, bashkë me të, mjaft protagonistë. Por vetëm kaq. Këtu, në kërkim të kohës sime të humbur, dëshiroj të rrëfej disa të vërteta të miat, të bëj një përpjekje për të kuptuar vetveten. Rrjedhimisht, edhe atë që kam shkruar deri tani. Me shpresë se do të mund të vazhdoj më tej, i qetë e me mendje të kthjellët, siç shprehet diku njëri nga personazhet e mi.

2.

Ndoshta si shenjë e fatit, jeta ka nisur për mua me një dështim. Duhet të kem qenë shtatë vjeç, do të hyja në klasë të parë dhe atëherë klasa e parë niste në moshën shtatë vjeç. Bashkë me vëllanë tim më të vogël Rolandin, im atë na çoi për pranim në Liceun Artistik. Godina e Liceut ndodhej te rruga e Kavajës, aty ku sot gjendet Muzeu i Shkencave të Natyrës, nëse vazhdon të gjendet: para ca kohësh kam dëgjuar për një lëvizje të mundshme të tij prej andej.

Dëshiroja me gjithë shpirt të pranohesha, të bëhesha violinist ose pianist. Na mori në provë një grua, na kërkoi të riprodhonim tingujt e pianos dhe s'më kujtohet çfarë tjetër. Rolandi u pranua, unë jo. Im atë më shpjegoi se që të pranohesha në Lice duhej të kishe vesh muzikor, talent. Unë dola pa vesh muzikor, pa talent. Dhe qava. Ndërsa Rolandi, me gjithë veshin muzikor, çdo mbrëmje i ankohej tim eti se nuk i pëlqente Liceu. Arsyeja: atje kishte vetëm vajza, ai s'mund të rrinte vetëm me vajza. Më pas zuri të mos shkonte fare në shkollë dhe prindërit u detyruan ta hiqnin nga Liceu.

Vite më vonë im atë bëri një përpjekje të dytë me vëllanë tjetër Artanin, lindur njëmbëdhjetë vjet

pas meje, që më në fund njëri nga fëmijët të dilte muzikant, më saktë violinist. Violina e tij ka qenë jo e zakonshme, e afërt me violinat e familjes Stradivari. Ibrahim Madhi dhe Piro Gjezi koncertet e tyre të diplomës i kanë dhënë me violinën e tim eti. Ai nuk e jepte instrumentin, s'më kujtohet ndonjë rast tjetër i ngjashëm, por ata i çmonte shumë dhe nuk i refuzoi kur ia kërkuan t'ua huazonte. Meqë ra fjala, pas vdekjes së tim eti, erdhi më takoi një ditë në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", ku punoja, një i njohur i vjetër i viteve të rinisë, violinisti Robert Papavrani. Atëherë djali i tij Tedi vazhdonte të studionte për violinë në Francë dhe Roberti ishte në kërkim të një violine në përputhje me klasin e të birit. I thashë se do të isha i lumtur sikur violina e tim eti, mbetur "shurdh", të përfundonte në duart e Tedit. Sigurisht, Roberti erdhi ta shihte, ta provonte. Por, për një arsye tek e cila nuk dua të zgjatem, i thashë se më vinte keq, kërkesa e tij ishte me vonesë.

Dëshira e tim eti për të nxjerrë violinist njërin nga djemtë e t'i linte trashëgim instrumentin, nuk u realizua. Artani, ashtu si Rolandi, doli me vesh të mirë muzikor dhe u pranua në Liceun Artistik, tashmë në godinën e re te rruga e Elbasanit. Por kishte një të metë serioze: i mungonte vullneti i duhur për t'u bërë violinist koncertesh, siç synonte im atë, dhe jo violinist i zakonshëm. Ai këmbënguli plot tetë vjet me të, i siguroi pedagogë violine si mikun e familjes tonë, të ndjerin Sofokli Paparisto, por pa dobi. Sipas tij, Artani "flinte mbi violinë".

Kësaj teme i jam kthyer një herë me tim atë në muzgun e jetës së tij. Ishte i përjashtuar nga partia, në shtëpinë tonë përveç ndonjë kushëriri të afërt dhe ndonjë vizitori të rrallë, as hynte as dilte

njeri. Ndodhte të grindeshim, të bënim debate me tone të larta, për të cilat ndihem i penduar. Në një gjendje mizerabël shpirtërore për vete, unë e ngarkoja me fajë, e akuzoja për veprime të gabuara. Një nga këto veprime, i thashë një mbrëmje, - ndërkaq Artani punonte si ekonomist diku, në Skrapar, - kishte qenë ngutja për ta hequr atë nga Liceu. Im atë reagonte keq ndaj ngacmimeve të mia, por kësaj radhe u tregua i përmbajtur. “Ti s`di asgjë, më tha, megjithëse shkruan. Unë e kam shpëtuar tët vëlla, pavarësisht çfarë po ndodh sot. Ai do të dilte një violinist grope, e di ti ç`janë violinistët e gropës? Janë ata që kur ti shkon ndonjëherë në opera, i sheh poshtë, në gropën e orkestrës. Po ta kisha lënë të vazhdonte më tej, ai do të ndihej inferior, do të më mallkonte gjithë jetën që e detyrova të bëhej violinist”.

Arsyetimi i tij nuk më bindi, nuk më pëlqeu shpërfillja që vura re tek ai për ata që i quante “violinistë grope”. Sidoqoftë, pa e menduar, ai më kishte prekur në një pikë të dobët. Unë vetë kam vuajtur nga ai që quhet “kompleks i inferioritetit”. Qyshse në fëmijëri im atë më çoi për pranim në Liceun Artistik dhe mua s`më pranuan, e m`u hoq mundësia të mësoja piano ose violinë, sepse isha pa talent.

Kësaj rrethane iu mbivendos një rrethanë tjetër, qesharake në dukje, por që më ka munduar më mizorisht se mungesa e talentit. Pas dhëmbëve të qumështit, më kishin dalë ca dhëmbë të mëdhenj. Shpesh mua nuk më thërrisnin në emër. Më thërrisnin ose më tregonin me nofkën “dhëmbçi”. Më të mëdhenjtë, kur donin të talleshin me mua, më quanin “dhëmbç”. Ndihesha i fyer, sidomos kur kjo ndodhte në prani të vajzave. Më hipte të ngrija

krye, të kacafytesha, por këtë nuk e bëra kurrë, nuk ka ndodhur në jetën time të jem rrahur me dikë, më ka munguar shpirti luftarak, e kjo gjithashtu s`mund të konsiderohet veti pozitive.

Të të quajnë pa talent dhe të të thërrasin “dhëmbç” më duket se janë të mjaftueshme të ndihesh fatkeq. Duhet të kem qenë në klasën e katërt ose të pestë fillore kur një ditë, në shkollë, i nënshtuar ndaj fatkeqësisë time, dëgjova drejtoreshën t`i thoshte një grumbulli nxënësish dhe mësuesish: “Ja, shihni një talent të vërtetë!”. S`mund të them në ç`rrethana ndodhi kjo dhe si u gjenda i pranishëm. Por skena më është ngulitur në kujtesë e pashlyeshme, siç m`u ngulitën fytyra dhe emri i djalit, për të cilin u thanë fjalët lavdëruese: piktori Edi Hila. Me Edin jam njohur dekada më vonë, në fillim të viteve `70. Atëherë ai vlerësohej si një nga talentet më të spikatura të pikturës shqiptare, njëherazi pati edhe shumë telashe për shkak të pikturave të tij. Edit ka të ngjarë të mos i kujtohet kjo hollësi, as vizatimi për të cilin drejtoresha e mburrte: një fëmijë në dritaren e hapur të dhomës, duke vështruar natën qiellin e mbushur me yje. Dhe hënën e ndritshme. Një vizatim bardhë e zi, me laps. U magjepsa. E pata zili atë djalë të panjohur, ai nuk ishte as “dhëmbç”. U ktheva në shtëpi dhe provova të vizatoja. Mbaj mend të jem regjistruar në një rreth vizatimi. Më kot. Edhe për këtë më mungonte talenti.

Një provë e fundit për të matur forcat ka qenë teatri. Kam pasur mësuese kujdestare një grua me flokë të zinj, të prerë shkurt. Nëse kujtesa s`më gabon rëndë, kjo ishte bashkëshortja e të paharruarit Prokop Mima. Duket, në kuadrin e veprimtarive jashtëshkollore, ajo kërkoi një ditë në klasë disa

nxënës, vullnetarisht, për të luajtur një pjesë teatrore. Unë pranova pa ngurrim. Prokop Mima erdhi disa herë në klasën tonë, na bënte prova pas mësimit, dhamë një shfaqje, por unë nuk e mora vesh kisha apo nuk kisha talent. Fakti është se nuk u bëra aktor.

Ato kohë ne banonim në katin e dytë të një shtëpie dykatëshe prej qerpiçi, pronë e një tiranasi të quajtur Haxhi Ruka. Ajo vazhdon të gjendet atje ku ka qenë, përballë godinës së ish-Shtëpisë së Oficerëve, më pas Lidhja e Shkrimtarëve, aktualisht Ministria e Kulturës. E kam përshekruar ashtu siç ka qenë te romani “Lëkura e qenit”. Prindërit e mi u vendosën në Tiranë nga viti 1946, kur isha tre vjeç. Në fillim kemi banuar në një vilë te rruga përbri rrugës së Durrësit, ku sot gjenden një varg dyqanesh dhe agjencish ajrore, prapa ish-pastiçerisë “Flora”. Për atë vilë kam kujtime të turbullta, nuk banuam gjatë atje. Kujtimet e mia qartësohen disi te shtëpia dykatëshe prej qerpiçi, ku qëndruam deri në vitin 1958, për t’u larguar prapë prej andej, në një zhvendosje nga lagjja në lagje, zhvendosje që për mua vazhdon edhe sot, duke më krijuar ndër vite ndjesinë e njeriut për të cilin zakonisht përdoret fjala “rrënjëshkullur”.

Nga fundi i viteve ‘40, fillimi i viteve ‘50, im atë duket kalonte një periudhë të vështirë: punonte në Radio-Tirana pasi ishte shkarkuar, siç dëgjoja në bisedat e të rriturve, nga posti i nënkryetarit të Komitetit të Kulturës dhe Arteve, i barazvlefshëm me postin e zëvendës ministrit. Dhe pinte shumë. Pas vdekjes së tij, nëna më ka shpjeguar një herë se im atë e kishte përdorur pijen me kohë, por në atë periudhë kishte kaluar çdo masë. Sipas nënës,

shkak qe bërë vdekja në burg e njerit prej vëllezërve të tij, dhe ai, me gjithë njohjet dhe lidhjet me regjimin, deri në sferat më të larta, s'kishte mundur të bënte asgjë për ta shpëtuar. E ndjera nëna ime, nuk e duronte njeriun e pirë dhe iku nga kjo botë me një dëshpërim të pangushëllueshëm: edhe djemtë, po të përdor një term të zbutur, i dolën qejflinj të mëdhenj alkooli. Unë kam hequr dorë nga dymbëdhjetë vjet të shkuara, kur pata një krizë hipertensionale, u shtrova në spital dhe mjekët më thanë se kisha shpëtuar mrekullisht nga vdekja. Megjithatë, e pohoj, ndonëse kjo është një deklaratë jo edukative, për të cilën kërkoj ndjesë: më kanë pëlqyer gjithmonë edhe alkooli edhe duhani. Duhani pata vullnetin e duhur ta hiqja vetë, pasi e kisha pirë për tridhjetë vjet. Alkoolin, siç thuhet, ma hoqi Zoti për dënim.

Asaj periudhe i përkasin një numër personazhesh, miq apo të njohur të tim eti, ndër të parët e regjistruar në kujtesën time. Por para se të flas për ndonjërin prej tyre sqaroj: ka të ngjarë të bëj ngatërresa vendesh dhe në rendin sipas të cilit ata vijnë në skenë, për të dalë kush më shpejt e kush më vonë. Saktësia në këtë pikëpamje nuk më intereson, nuk është qëllimi im, gjërat i riprodhoj siç më vijnë. Periudha '48-'56 mbërrin tek unë në trajtat e një muzgu ku lëvizin hije, në një mish-mash vegimesh. Si në një tablo surrealistike bardhë e zi.

I pari shkëputet nga errësira një personazh i veçantë tragjik. Ky ishte një burrë shtatmesatar, me një kërrusje të lehtë, fliste një dialekt të kulluar elbasanas, si prindërit e mi, dhe e quanin Mustafa Bodini. Në Elbasan nuk besoj të ketë njeri që të mos e njohë këtë emër, të mos dijë të këndojë këngët e tij. Mustafa Bodini bën pjesë në grupin e krijuesve

të këngës popullore qytetare elbasanase, me korife Isuf Myzyrin.

Ndodhte që ky njeri të vinte në shtëpinë tonë me tim atë. Por ndodhte të vinte vetëm. Gjendej apo nuk gjendej im atë, ai rrinte në pritje dhe kur ky vonohej, nuk largohej pa pirë më parë ndonjë gotë raki, përveç rasteve kur nëna i thoshte se nuk kishte raki, dhe në të shumtën e rasteve nuk kishte. Mustafai nuk e prishte qejfin edhe pse nëna i rrinte ftohtë, mezi priste që ai të largohej, një nga arsyet që unë ndieja mëshirë për të. Mbi të gjitha, kur vinte Mustafai, unë dhe im vëlla kishim porosinë e prerë të mos i afroheshim, të mos i prananim përkëdheljet e tij. I shkreti Mustafa, vuante nga një sëmundje lëkure, nuk ia di emrin. Është ajo sëmundja që përhapet në fytyrën e njeriut duke e bërë pulla-pulla, pastaj kalon në kokë, në qafë e te duart. Babai i shpjegonte nënës se nuk duhej të merakosej nga sëmundja e tij, nuk ishte ngjitëse. Megjithatë nëna kishte gjithmonë merak kur vinte ai dhe për ne urdhri për të mos iu afruar mbetej në fuqi.

E pra, Mustafai paskej qenë i pashëm. Para Luftës kishte vajtur në Itali të studionte për aktor ose regjisor teatri. Nuk më kujtohet të kem mësuar nëse i kishte mbaruar studimet, apo jo. Me të plasur lufta ai qe kthyer në Shqipëri, në qytetin e lindjes, Elbasan, ku, siç dëgjoja, do të bënte një gafë: me hyrjen e trupave pushtuese italiane, paskej veshur këmishën e zezë fashiste. Sipas tim eti, Mustafai nuk ngatërrohej me politikë por e kishte bërë atë marrëzi ngaqë ishte tip i shkujdesur, për t'u dukur i modës.

Në gjendjen e vështirë të atyre viteve, im atë u përpoq ta ndihmonte, falë ndërhyrjes së tij e punësuan në Teatrin Popullor. Mirëpo tashmë